



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 22.32.1-2016-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË  
HANIT TË ELEZIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31  
DHJETOR 2016**

**Prishtinë, qershor 2017**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Florim Maliqi – udhëheqës i ekipit, Mexhit Ferati, dhe Arben Hundozi, anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të auditimit Fatlinda Ramosaj.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	15
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	24
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	25
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak .....	28
Shtojca IV: Komentet e Komunës në gjetjet e auditimit .....	31

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky draft Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit<sup>1</sup>, të datës 29.11.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Më hollësisht, shih Shtojcën 1.

Niveli i punës së kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërdrejt cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Hanit të Elezit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet material.

#### Theksimi i çështjes

Si Theksim të Çështjes dëshirojmë të përmendim faktin se pasuria ishte nënvlerësuar për 207,011€. Po ashtu, Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve në vlerë 40,624€.

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

<sup>1</sup> Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit"

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore****Përgjigja e Kryetarit të Komunës**

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit. Komentet e Kryetarit të Komunës për çështjet për të cilat nuk jemi pajtuar janë dhënë në detaje në Shtojcën IV.

---

# 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne, gjithashtu, e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.1 Opinioni i auditimit

### Opinioni i Pamodifikuar me Theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren e MF nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar të Organizatave Buxhetore.

### Baza për opinion

Auditimi ynë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

---

## **Theksimi i çështjes**

Si theksim të çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

Vlera e pasurive të regjistruara në regjistrin e pasurive dhe të prezantuara në PFV nuk ishte e plotë pasi që komuna nuk ka arritur t'i regjistroj të gjitha investimet kapitale të përvetësuara gjatë vitit 2016 në shumë 240,760€, ndërsa nga ana tjetër vlera e pasurisë ishte mbivlerësuar për 33,749€ si pasojë e keq klasifikimit. Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte bërë pagesa 33,749€, për realizimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor shtëpiak i cili menaxhohet nga një OJQ, ndërsa këto shpenzime i takojnë mallrave dhe shërbimeve. Në bazë të raportit të ofruar nga komuna, bashkë financuesi për projektin e lartpërmendur ka angazhuar 8 punëtorë shëndetësor duke kryer shërbime në objektin e Qendrës së Mjekësisë Familjare dhe disa aktivitete në terren. Po ashtu, shuma prej 2,850€ ishte paguar në emër të shpenzimeve për rehabilitimin e 15 personave në banjën e Kllokotit. Përfitues të këtyre shpenzimeve nuk ishin punëtorë të komunës, por anëtarë të familjeve të dëshmorëve, deri sa ato shpenzime i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve si dhe shpenzimet në shumë 4,025€ në emër të makinave mjelëse ishin regjistruar si subvencione të cilat do duhej të regjistroheshin si transfere kapitale.

## **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV**

Kryetari i komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq deklarim material që mund të ekzistoj. Keq deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Kryetari i Komunës kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Nëse PFV janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në MF;
- Nëse Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit është dorëzuar me kohë; dhe
- Nëse Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe një kopje tek MF.

Draft PFV fillestare përmbanin disa gabime financiare dhe ne i kemi dhënë komunës disa sugjerime për të përmirësuar cilësinë e tyre, si në vijim:

- Grantet e përcaktuara të donatorëve në raportin e ekzekutimit të buxhetit janë paraqitur gabimisht në vlerë 44,000€ në kolonën e buxhetit final dhe të realizimit duke përfshirë edhe grantet e bartura nga viti i kaluar në vlerë 10,000€. Ato ishin shpalosur gabimisht edhe në shënimin 12;
- Shpenzimet komunale në raportin e ekzekutimit të buxhetit në kolonën e realizimit janë paraqitur saktë në vlerë 48,000€ ndërsa tek shpalosja e shënimit 4, janë paraqitur gabimisht në vlerë 49,000€;



- Subvencionet dhe transferet në raportin e ekzekutimit të buxhetit në kolonën e realizimit janë paraqitur saktë në vlerë 53,000€, ndërsa tek shpalosja e shënimit 4 janë paraqitur gabimisht në vlerë 54,000€;
- Shpenzimet kapitale në raportin e ekzekutimit të buxhetit në kolonën e realizimit janë paraqitur saktë në vlerë 486,000€ ndërsa tek shpalosja e shënimit 6 janë paraqitur gabimisht në vlerë 487,000€;
- Tek shënimet shpjeguese 2 deri 6 te kolona e Buxhetit Final mungon shpalosja nëpër kode ekonomike, por është vendosur vetëm totali;
- Neni 24 Raporti për bartjen e fondeve të pushpenuara të donatorëve nuk është plotësuar as për vitin aktual e as për vitet paraprake.

Sugjerimet tona janë marrë parasysh nga komuna dhe gabimet e përmendura më lartë janë korrigjuar, ndërsa në PFV finale ende kanë mbetur gabime që kanë të bëjnë me:

- Shpalosja e stoqeve nuk ishte e saktë, pasi nuk janë marrë në konsideratë edhe stoqet e Qendrës së Mjekësisë Familjare; dhe
- Përmbledhja e pasurive jo financiare mbi 1,000€ nuk ishte e plotë. Këtë çështje më gjerësisht e kemi trajtuar tek nënkapitulli 1.1 Opinioni auditimit.

## DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I KOMUNËS

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, përveç çështjeve të theksuara tek opinioni, por që nuk konsiderohen me ndikim material.

## 1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e sipër përmendura jepet rekomandimi:

**Rekomandimi 1** Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së Opinioni dhe të merren veprimet e duhura për t'i evituar gabimet në keq klasifikimin e shpenzimeve dhe mos regjistrimin e saktë të pasurive. Gjithashtu, duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport dhe Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

---

## 2 Qeverisja

### Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për menaxhmentin e komunës që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të siguroj ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, pasi kjo tregon nëse menaxhmenti është duke i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive në sistemin qeverisës të komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial.

Lista kontrolluese e vet-vlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, duke iu përgjigjur shumicës së pyetjeve me notë mesatare prej 2.46. Sipas listës së vet-vlerësimit komuna kishte dhënë përgjigje negative në 16 pyetje. Kjo do të thotë se menaxhmenti duhet të marrë parasysh çështjet të cilat nuk kanë arritur nivelin e pritur.

Një ndër elementet kyçe të një qeverisje efektive të komunës është edhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i jashtëm. Auditimi i këtij viti ka nxjerrë në pah se niveli i rekomandimeve të zbatuara nga viti i kaluar ishte i ulët, dhe vetëm dy (2) nga nëntë (9) rekomandimet ishin zbatuar.

Komuna ka planin zhvillimor, por ky plan nuk përfshinë llogaritjen e kostove për matjen e rezultateve të objektivave të saj. Plani zhvillimor i komunës me shumë prezanton statistika se sa trendin e zhvillimit të vet komunës.

Përveç një liste të rreziqeve të përgatitur në fund të vitit 2016, por që i mungon qasja e veprimit ndaj këtyre rreziqeve, komuna nuk ka përgatitur as planin emergjent dhe planin anti korrupsion.

## 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti jonë i auditimit për PFV-të 2015 ka rezultuar me 9 rekomandime. Komuna e Hanit të Elezit ka përgatitur dhe dorëzuar me kohë Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga viti paraprak. Raporti ynë ishte diskutuar edhe në Kuvendin Komunal. Deri në përfundim të auditimit 2016, dy (2) rekomandime ishin zbatuar, tre (3) ishin në proces të zbatimit dhe katër (4) nuk ishin zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën III.

### Çështja 2 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

**E gjetura** Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse menaxhmenti nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, e as që ka aplikuar masa përgjegjësie lidhur me mos adresimin e rekomandimeve

**Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiarë kyçe kanë rezultuar në:

- Përsëritje të keq klasifikimit të shpenzimeve kapitale;
- Dobësive lidhur me të arkëtueshmet nga qiraja;
- Dobësi në hartimin e qasjes për menaxhimin e rreziqeve ; dhe
- Dobësi të vazhdueshme në shpenzimet përmes prokurimit dhe vlerë të dobët për paranë.

**Rekomandimi 2** Kryetari duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike për të identifikuar dhe eliminuar barrierat gjatë procesit.

## 2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuar në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese dhe kemi përmbledhur më poshtë të gjeturat tona. Kjo nuk ka për qëllim të ofroj komente për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit, por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

### Çështja 3 - Pyetëtori i vet-vlerësimit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponentë. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

- Pyetëtori i vetvlerësimit i plotësuar nga stafi komunal ka dëshmuar se komuna ka hartuar listën e rreziqeve të cilat mund të ndodhin dhe të cilat mund të ndikojnë në arritjen e objektivave, por kësaj liste i mungojnë masat dhe veprimet adekuate të menaxhmentit kundrejt ndodhjes së mundshme të këtyre rreziqeve;
- Proceset efektive të monitorimit si dhe mungesa e strategjisë gjithëpërfshirëse të zhvillimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) nuk janë të vendosura nga Komuna; dhe
- Komuna gjatë vitit 2016 kishte raportuar në MF progresin fizik dhe financiar sipas kërkesave të ligjit të buxhetit, të cilat janë shqyrtuar më hollësisht në nënkapitullin 2.3.1.

**Rreziku** Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

**Rekomandimi 3** Kryetari duhet të siguroj se është hartuar strategjia zhvillimore gjithëpërfshirëse duke përfshirë palët e interesit dhe duke llogaritur kostot për zbatimin e saj, si dhe lista e rreziqeve të plotësohet me masat që duhet të ndërmerren për të minimizuar dëmet në rast të ndodhjes së ndonjë rreziku.

## 2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballet.

### 2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Komuna është e obliguar të përgatisë dhe të përcjellë zbatimin e planeve strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal, etj.

Komuna ka hartuar dokumentet strategjike, si: Plani urbanistik dhe planin e integruar zhvillimor 2016-2018.

#### Çështja 4 – Planet strategjike – Prioritet i lartë

<b>E gjetura</b>	Komuna nuk pasur plan strategjik zhvillimor prej vitit 2011, por ka pasur një plan të përgjithshëm të zhvillimit, në të cilin nuk ka qartësuar përgjegjësitë për koordinimin dhe zhvillimin e tij, si dhe mungon llogaritja e kostove të planit zhvillimor. Komuna nuk ka plan të hartuar kundër korrupsionit dhe as planin operativ emergjent.
<b>Rreziku</b>	Mungesa e planit strategjik rrezikon prioritizimin e çështjeve kyçe të cilat kanë të bëjnë me orientimin dhe zhvillimin e komunës në periudha afatgjata dhe pamundëson përcjelljen e përmbushjes së objektivave në pikëpamje të vizionit si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë.
<b>Rekomandimi 4</b>	Kryetari duhet të miratoj një plan të përgjithshëm strategjik për komunën i cili do të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbejë si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore, kryerjen e analizave krahasuese mes viteve dhe matjen e rezultateve kundrejt objektivave.

### 2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Pas rishikimeve tona kemi vërejtur disa dobësi siç janë përshkruar në vijim.

---

## Çështja 5 - Dobësi në kontrollet menaxheriale - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të mangët financiar mbi shpenzimet, të hyrat, të arkëtueshmet dhe të pagueshmet, tek menaxhmenti i lartë, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth variancave në buxhet, si dhe të njëjtat nuk janë azhurnuar në baza mujore. Ngjashëm, synimet operationale nuk menaxhohen në mënyrë sistematike.
- Rreziku** Cilësia e dobët e raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë, redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e komunës në mënyrë pro aktive si dhe ulë efektin e kontrolleve buxhetore.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të siguroj se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2017.

## 2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Komuna e Hanit të Elezit nuk ka Njësi të Auditimit të Brendshëm (NjAB). Shërbimet e auditimit të brendshëm për vitin 2015 dhe gjysmën e vitit 2016 për nevoja të komunës, i kishte kryer Ministria e Financave, përkatësisht Njësia Departamenti i AB në Ministrinë e Financave.

---

## Çështja 6 - Mungesa e NJAB - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Komuna e Hanit të Elezit nuk e ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NJAB). Shërbimet e auditimit të brendshëm për vitin 2015 dhe gjashtë mujorin e parë të vitit 2016 i kishte kryer departamenti i auditimit të brendshëm në MF. Nga ky auditim ishin dhënë katër (4) rekomandime, për të cilat menaxhmenti ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve përkatëse të raportit të auditimit.
- Rreziku** Fakti se shërbimet e auditimit janë kryer pjesërisht për periudhën 6 mujore 2016 mund të rezultojë me përfitime të pa mjaftueshme të menaxhmentit nga shërbimet e kryera nga MF, respektivisht me vlerësime të mangëta të kontrolleve të brendshme.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të rishikoj mundësitë buxhetore që të formoj NJAB e cila do të kontribuonte më shumë në vlerësimin dhe përmirësimin e kontrolleve të brendshme. Në të kundërtën, këto shërbime vjetore të vazhdoj t'i kryej MF apo ndonjë komunë tjetër e afërm.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore, si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Për komunën, prokurimi mbetet ndër sfidat kryesore, për shkak se rregulloret nuk janë aplikuar si duhet, dhe kjo ka rezultuar në vlerë të dobët për para. Numri i madh kontratave me vlerë minimale përshkruan më së miri dobësitë në planifikimin e prokurimit, pastaj mos aplikimin e procedurave adekuate të prokurimit duke pasur parasysh natyrën e njëjtë të shërbimeve. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat, në përgjithësi, janë më të mira, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar komunën që mos të pësoj dëme buxhetore. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë pagesat në emër të bashkëfinancimeve, keq klasifikimi i shpenzimeve si dhe mbledhja e të arkëtueshmeve, sidomos ato nga taksa në biznes.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	280,000	280,000	251,831	223,521	233,030

Në vitin 2016, plani i të hyrave ishte realizuar 90%, me një rritje simbolike nga viti 2015 ku të hyrat ishin mbledhur 87%, ndërsa në vitin 2014 plani ishte realizuar 79%. Pra, në vitin 2016 realizimi i të hyrave vetjake nuk ka shënuar ndonjë rritje krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat përfshirë edhe ato të bartura nga viti paraprak, ishin shpenzuar kryesisht për projekte kapitale në shumë 256,641€, për mallra dhe shërbime 14,932€, dhe për subvencione dhe transfere 23,158€.

**Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>2,066,396</b>	<b>2,309,939</b>	<b>2,189,897</b>	<b>2,094,367</b>	<b>1,902,070</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,786,396	1,856,678	1,851,081	1,901,743	1,620,495
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup> -	-	129,093	106,108	44,134	27,144
Të hyrat vetjake <sup>4</sup>	280,000	280,000	188,624	94,536	233,030
Donacionet e jashtme	=	44,168	44,084	53,954	21,401

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar ishte më i lartë për 243,543€. Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i rritjes së Grantit Qeveritar prej 70,282€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar 129,093€ dhe të hyrave nga donacionet e jashtme 44,168€.

Ekzekutimi i buxhetit në vitin 2016 ishte 2,189,897€ ose 95% nga buxheti final, deri sa në vitin 2015 ishte 93%, e po aq edhe në vitin 2014. Ne përgjithësi, komuna ka treguar një nivel të lartë të performancës buxhetore, përveç kategorisë së investimeve kapitale.

**Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>2,066,396</b>	<b>2,309,939</b>	<b>2,189,897</b>	<b>2,094,367</b>	<b>1,902,070</b>
Pagat dhe Mëditjet	1,366,516	1,396,798	1,391,497	1,366,432	1,239,194
Mallrat dhe Shërbimet	170,000	212,026	211,387	264,565	147,697
Shërbimet komunale	44,533	48,814	48,264	48,061	35,918
Subvencionet dhe Transferet	51,104	53,546	53,159	47,640	37,163
Investimet Kapitale	434,243	598,755	485,590	367,669	442,098

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për investime kapitale në vitin 2016 ishte rritur për 164,512€. Niveli i ekzekutimit të buxhetit final ishte 81%. Shpenzimet kapitale kanë shënuar një rritje për 117,921€ krahasuar me vitin 2015. Programi për Investime Publike përfshin tetë (8)projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe 16 projekte të reja për vitin aktual;
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 30,282€, është rezultat i pagesave për përvojën e punës;

<sup>2</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.



- 
- Rritja e buxhetit tek kategoria mallra dhe shërbime në shumë 42,026€ si dhe shpenzimet komunale në shumë 4,281€ ishte bërë për shkak të obligimeve të mbetura nga vitit paraprak;
  - Buxheti për subvencione dhe transfere është rritur për 2,442€ për shkak të nevojave për ndihmë për entitetet jo publike. Pavarësisht kësaj, në fund të vitit 2016 shuma 6,000€ kishte mbetur si shumë e obligimeve të pa paguara ndaj përfituesve individual; dhe
  - Donacionet e jashtme ishin 44,168€ të cilat ishin shfrytëzuar për investime kapitale në shumë 42,058€, dhe 2,026€ për mallra dhe shërbime.
- 

### Çështja 7 - Realizimi i buxhetit - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Komuna ka treguar një efikasitet të lartë në realizimin e buxhetit pothuajse në të gjitha kategoritë e shpenzimeve. Mirëpo, një ngecje në krahasim me kategoritë tjera, vërehet për investime kapitale (81%). Kjo përqindje bie edhe më tej nëse e marrim parasysh vlerën e keq klasifikimeve. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së planifikimit dhe kontrollit sistematik buxhetor të komunës dhe pjesërisht për shkak të disa faktorëve të jashtëm.
- Rreziku** Mosrealizimi i buxhetit sipas projeksioneve fillestare do të rezultoj në mos arritjen e objektivave të komunës dhe në financimin e projekteve dhe detyrimeve të vitit aktual nga buxheti i vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të siguroj dhe të përcaktoj objektiva të qarta për përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në periudhat e ardhshme, dhe të vendos një monitorim sistematik mbi ekzekutimin e buxhetit të planifikuar, sidomos për projektet kapitale.

### 3.1.1 Të hyrat

Komuna e Hanit të Elezit grumbullon disa lloje të të hyrave, por ato më domethënëse janë: tatimi në pronë, taksa për regjistrimin e automjeteve, taksa për biznese, qiraja nga prona si dhe taksat tjera administrative. Shuma totale e të hyrave vetjake të komunës, të mbledhura gjatë vitit 2016 ishte 251,831€ apo 90% nga plani.

Pavarësisht kontrolleve të vendosura nga komuna, ne kemi identifikuar disa çështje me rëndësi nga auditimi i të hyrave:

#### Çështja 8 - Moszbatimi i softuerit për taksa në firmë- Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna posedon një softuer të kontabilitetit për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave nga taksa e biznesit. Ky softuer i blerë në vitin 2012 në shumë 9,800€ ka mbetur vetëm si pasuri pasive e komunës, pasi që i njëjti nuk ka gjetur zbatim në praktikë. Sipas zyrtareve të komunës softueri ka pasur për qëllim regjistrimin e të dhënave nga taksa në firmë, por fatkeqësisht kjo nuk është shfrytëzuar nga drejtoria për zhvillim ekonomik. Evidenca për 257 biznese mbahet në programin aplikativ Excel, por ky program aplikativ nuk jep shumë informata analitike për secilin biznes.

Po ashtu, në bazë të testimit të tetë (8) mostrave kemi vërejtur se komuna ka lëshuar aktvendime për operimin e bizneseve të cilat kishin borxhe të larta paraprake, ku borxhi sillej për operator prej 2,430€ deri në 74,000€. Sipas aktvendimeve të lëshuara për operim nga komuna thuhet se deri më datën 15.06.2016 duhet të kryhen obligimet ndaj komunës. Ky kriter nuk ishte plotësuar nga ushtruesit e veprimtarisë afariste dhe komuna nuk kishte dhënë ndonjë vërejtje me shkrim e as që kishte aplikuar ndonjë masë tjetër.

**Rreziku** Mos aplikimi në praktikë i Softuerit për shkaqe të panjohura, flet për një performancë të dobët të menaxhimit të bazës së të dhënave nga taksa në firmë. Zbatimi i sistemit manual për grumbullimin e informatave në lidhje me të hyrat nga taksa, mund t'i nënshtrohet manipulimit me të dhëna apo gabimeve. Po ashtu, dhënia e vendimeve për ushtrimin e veprimtarisë afariste pa i kryer obligimet paraprake, rrit rrezikun për mos inkasimin e të hyrave sipas planit dhe shfrytëzimin e tyre sipas prioriteteve.

**Rekomandimi 8** Kryetari duhet të kërkojë arsyet përse softueri i blerë ka mbetur pasiv vite me radhë, dhe të siguroj se i njëjti do të vihet në funksion me qëllim që mbajtja e të dhënave të ofroj informata të mjaftueshme për secilin biznes apo të kërkoj një përmirësim në formatin ekzistues të mbajtjes së të dhënave në Excel. Gjithashtu, duhet të kërkoj veprime konkrete nga organet kompetente për ndalimin e atyre bizneseve të cilët nuk i janë përgjigjur obligimeve ndaj komunës.

---

**Çështja 9 – Falja e borxheve pa bazë ligjore – Prioritet i lartë**

- E gjetura** Drejtori i Urbanizmit kishte marrë një veprim të pavarur lidhur me borxhet e qiramarrësve. Ne kemi gjetur se ishin falur borxhet e qirasë për 14 qiramarrës të pronës komunale në vlerë totale 6,615€, duke u bazuar në ligjin për faljen e borxheve. Ky ligj nuk e parasheh faljen e borxheve për qiratë.
- Rreziku** Falja e borxheve të qirasë pa bazë të ligjore, është në kundërshtim me ligjin dhe shkakton humbje financiare për komunën. Po ashtu, një veprim i tillë duke falur borxhin për qiramarrës të cilët nuk kanë paguar vite me radhë, mund të shkaktoj pakënaqësi tek qiramarrësit të cilët kanë paguar vazhdimisht.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të rishikoj rastet e mësipërme të faljes së borxheve dhe të siguroj se falja e borxheve bëhet vetëm për kategoritë e lejuara me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Para marrjes së vendimeve, rastet të shqyrtohen paraprakisht dhe të sigurohet se vendimet e marra janë në përputhje të plotë me ligjet apo rregulloret përkatëse.

**3.1.2 Pagat dhe mëditjet**

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë më: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqesin në mes të formularëve; rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin me thesar. Shpenzimet për paga dhe mëditje për vitin 2016 ishin 1,391,497€ apo 100% e buxhetit për këtë kategori.

---

**Çështja 10 – Kategorizimi i gabuar i gradimit – Prioritet i lartë**

- E gjetura** Në një (1) rast kemi evidentuar se një i punësuar në departamentin e shërbimeve të shëndetësisë primare është kategorizuar në gradën e doktorit si specialist, deri sa nuk posedon dëshmi për këtë kualifikim. Gradimi i gabuar, ka rezultuar që paga vjetore bazë të jetë më e lartë për 1,092€.
- Rreziku** Mos kategorizimi i duhur i të punësuarve sipas gradave të përcaktuara për klasifikim të pagave ka rezultuar me mbishpenzim të pagave, përkatësisht shpenzim të parregullt të buxhetit.
- Rekomandimi 10** Kryetari duhet të forcoj kontrollat e procedimit të dhënave të personelit në sistemin e pagave dhe të siguroj marrjen e veprimeve të nevojshme për kategorizimin e drejtë të të punësuarve sipas klasifikimit të përcaktuar të gradave të pagave.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 212,026€, të cilat pothuajse ishin shpenzuar në tërësi (211,387€). Obligimet e papaguara për mallra dhe shërbime në fund të vitit 2016 ishin 3,380€.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 53,546€. Prej tyre ishin shpenzuar 53,159€. Shuma 12,025€ ishte shpenzuar për subvencione për entitete publike dhe jo publike, ndërsa shuma 41,134€ ishte shpenzuar si transfere mjjetesh për përfitues individual.

Dobësitë e identifikuar në këtë fushë janë trajtuar tek Baza për opinion.

### 3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 598,755€. Prej tyre ishin shpenzuar 485,590€. Komuna e Hanit të Elezit në vitin 2016 ka zhvilluar 88 aktivitete të prokurimit.

Dobësitë e identifikuar janë paraqitur në vijim:

#### Çështja 11 - Lidhja e kontratave me vlerë minimale- Prioritet i lartë

**E gjetura** Sipas listës së prokurimit kemi gjetur se janë kryer 51 aktivitete të prokurimit duke zbatuar procedura të prokurimit me vlerë minimale. Në kuadër të këtyre aktiviteteve kishte raste ku ishin zhvilluar më shumë se një procedurë për artikuj të njëjtë të prokurimit, por kishte raste edhe të kontratave të cilat nuk ishin paraparë në planin e prokurimit.

- Sipas planit të prokurimit ishte paraparë që hartimi i projekteve të jetë në vlerë 15,000€, ndërsa ishin zhvilluar 6 procedura me vlerë minimale për këtë lloj blerje;
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik nuk ishte përfshirë fare në planin e prokurimit edhe pse ky shërbim është i rregullt çdo vit, ndërsa ishin zhvilluar dy procedura me kuotim të çmimit për këtë lloj blerje;
- Për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve ishin planifikuar mjete në shumë 9,000€, ndërsa ishin zhvilluar tri procedura të ndara të prokurimit si rezultat i mos përfshirjes së të gjitha automjeteve që disponon komuna; dhe

- Furnizimi me material zyrtar ishte planifikuar në vlerë 4,500€, ndërsa ishin zhvilluar katër (4) procedura të ndara. Një rast ishte zhvilluar me procedurë të hapur dhe në tre raste kontratat ishin lidhur me vlerë minimale me të njëjtin operator.

**Rreziku** Ndarja e kërkesave dhe zhvillimi i procedurave të shpeshta me vlerë minimale apo me kuotim të çmimeve për atikuj të njëjtë, ka si rezultat mos transparencën dhe eliminimin e konkurrencës nga mos përdorimi i procedurave të hapura të prokurimit.

**Rekomandimi 11** Kryetari duhet të siguroj se zyra e prokurimit përmbledhë të gjitha kërkesat për blerje të njëjta për të mundësuar zhvillimin e procedurave të hapura të prokurimit. Kjo do të mundësonte një konkurrencë më të lartë dhe çmime më të favorshme për buxhetin e komunës.

## 3.2 Pasuritë

### 3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Gjatë vitit 2016 Komuna nuk ka arritur të bëjë regjistrimin e plotë të pasurive mbi 1,000€ ngase nga shtatori i vitit 2016 zyrtari i pasurisë ka shkëputur kontratën me komunën. Mos regjistrimi i pasurisë kapitale sipas kategorisë përkatëse është trajtuar tek pjesa e Theksimit të Çështjes në Opinion, ndërsa në vijim do të paraqiten disa çështje tjera, të cilat komuna do duhej t'i merrte parasysh në vitin 2017.

#### Çështja 12 - Inventarizimi dhe përdorimi i E-pasurisë - Prioritet i lartë

**E gjetura** Kryetari i Komunës kishte caktuar me vendim komisionin për inventarizim me datë 07.08.2015. Ky komision nuk kishte përfunduar punën as në përfundim të auditimit tonë me datë 12.05.2017, pra ka një vonesë për gati dy (2) vite.

**Rreziku** Mos inventarizimi i pasurisë ka rrezik që mos të identifikohen të gjitha pasuritë në pronësi të komunës, e që mund të rezultojë me keq menaxhim, dëmtim dhe humbje të tyre.

**Rekomandimi 12** Kryetari duhet të sigurojë se komisioni i caktuar përkatës do të përshpejtoj dhe kompletoj punën e filluar më parë dhe do të dorëzoj raportin përfundimtar të rezultateve të regjistrimit. Në të kundërtën, të themeloj një komision të ri.

### 3.2.2 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

#### Çështja 13 - Depozita në bankë - Prioritet i lartë

**E gjetura** Sipas rregullave financiare, të gjitha mjetet që mbledhen nga komuna në të gatshme deri në 10€, duhet në fund të ditës të dërgohen në bankë. Ne kemi vërejtur vonesa në dorëzimin e 649€, të cilat ishin mbledhur prej datës 18.01. deri 22.01.2016, si dhe 19.09 deri 23.09.2016 ndërsa ishin depozituar në bankë me 25.01.2016 përkatësisht 26.09.2016. Kjo praktikë është e zakonshme në komunën e Hanit të Elezit.

**Rreziku** Moszbatimi i rregullave të Thesarit për depozitimin e parasë publike në fund të ditës, rrit rrezikun që mbajtja e parasë për disa ditë me radhë, të keqpërdoret apo të humbet.

**Rekomandimi 13** Kryetari duhet të siguroj se një praktikë e tillë do të ndërpritet, dhe të zbatohen kërkesat e rregulloreve financiare që të gjitha shumat e mbledhura në kesh, të depozitohen në bankë brenda afateve ligjore të përcaktuara.

### 3.2.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të komunës prezantojnë shuma të mjeteve që qytetarët dhe organizatat i detyrohen komunës për shërbimet, punët, mallrat apo pronat që i kanë përfituar nga komuna. Sipas shënimeve të prezantuara në PFV shuma totale e këtyre llogarive në fund të vitit 2016 ishte 451,291€.

#### Çështja 14 - Nivel i lartë i borxheve të pa mbledhura - Prioritet i lartë

**E gjetura** Edhe pse të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë pjesën më të madhe të të hyrave vetjake, ato në fund të vitit 2016 kanë rezultuar me një borxh të pa arkëtuar prej 195,641€. Rast tjetër me rëndësi, ishte edhe me borxhet nga taksa në firmë ku në fund të vitit 2016 ishin të pa arkëtuara 241,124€, ndërsa ato të qirasë për shfrytëzimin e pronës komunale ishin 14,526€. Këto tre lloje ishin prezantuar si llogari të arkëtueshme në fund të vitit. Ne nuk kemi vërejtur se komuna ka ndonjë strategji konkrete për inkasimin/zvogëlimin e të arkëtueshmeve.

Për vitin 2016 komuna ka ngarkuar taksën në firmë për biznese në shumë 89,585€, deri sa të hyrat e inkasuara për vitin 2016 ishin 70,458€ apo 79% nga plani. Sipas raportit financiar në fund të vitit 2016 kishte mbetur si llogari e arkëtueshme shuma 241,124€. Për më tepër, komuna nuk kishte marrë ndonjë veprim konkret, si vërejtje me shkrim. apo ndonjë masë tjetër.

**Rreziku** Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme redukton aftësitë e Komunës për financimin e projekteve nga të hyrat vetjake. Vonesa në hartimin e një strategjie për inkasimin e borxheve të mbetura mund të shpie në një situatë, që pas një kohe të caktuar, ato të shndërrohen në borxhe të këqija dhe të bëhen të pa mbledhshme.

**Rekomandimi 14** Kryetari duhet të siguroj një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e të arkëtueshmeve. Menaxhmenti duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative për inkasimin e tyre.

### 3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2016 ishte 10,231€, deri sa në vitin 2015 ishin 29,688 €. Po ashtu, në fund të vitit janë prezantuar detyrimet kontingjente si konteste gjyqësore në shumë 70,600€ deri sa në vitin paraprak ishin 72,000€. Sipas analizës së llogarive të pagueshme, kemi vërejtur se komuna në vitin 2016, ka paguar gjithsej 32,184€ fatura të papaguara të vitit 2015.

#### Çështja 15 – Menaxhim i dobët i detyrimeve - Prioritet i lartë

**E gjetura** Sipas një analize, del se komuna në vitin 2016, ka paguar fatura të vitit 2015 në shumë 32,184€, deri sa faturat e papaguara të prezantuara në fund të vitit 2015 ishin 29,688€. Sipas kësaj analize del se komuna nuk ka prezantuar drejtë obligimet e saj duke shkaktuar nënvlerësimin e tyre prej 2,496€;

Komuna nuk kishte pasur një plan të mirëfilltë të rrjedhës së parasë për pagesën e obligimeve të ndodhura. Në fund të vitit 2016 ishin regjistruar obligime nga kategoria subvencione dhe transfere në shumë 6,300€ deri sa shuma e mbetur e buxhetit për këtë kategori ishte 387€. Pra, është tejkalar buxheti për këtë kategori në shumë 5,913€.

**Rreziku** Komuna nuk ka prezantuar drejtë dhe saktë obligimet e vitit paraprak dhe si rezultat i kësaj ka nënvlerësuar obligimet e saj. Po ashtu, hyrja në obligime përtej ndarjeve buxhetore, veçanërisht për subvencione dhe transfere, mund të ketë si rrezik që një pjesë e buxhetit e vitit aktual të shpenzohet për obligimet e mbetura nga viti i kaluar.

**Rekomandimi 15** Kryetari duhet të siguroj se ekziston një raportim i drejtë dhe në kohë i të gjitha faturave të papaguara nga të gjitha departamentet, si dhe të siguroj se planifikimi i buxhetit bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkalar në asnjë rast ndarjet buxhetore.

---

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.



## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim	Prioritet i lartë - Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar në Theksim të Çështjes. Është e nevojshme që të ndërmerren veprimet e duhura për t'i adresuar shkaqet për mos regjistrim të pasurisë në SIMFK dhe të paraqitjes së saktë në PVF.			Nuk është zbatuar ky rekomandim. Mungesa e zyrtarit të pasurisë.
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin të plotë rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.	Po është zbatuar ky rekomandim.		
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të siguroj se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive.	Po është zbatuar ky rekomandim.		

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se pas hartimit të një liste të rreziqeve me nivelet përkatëse. Përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut është deleguar tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi mbarëvajtjen e procesit.		Pjesërisht është zbatuar ky rekomandim ngase nuk ishte paraparë edhe qasja për menaxhimin e rreziqeve.	
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të konsiderojë mundësinë e sigurimit të shërbimeve të auditimit të brendshëm, në mënyrë që të testoj përshtatshmërinë, efektivitetin dhe operimin e kontrolleve të brendshme të organizatës.		Pjesërisht është zbatuar ky rekomandim nga se nuk ishin kërkuar shërbime të auditimit të cilat do të përfshinin periudhën vjetore.	
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike dhe janë identifikuar barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar.			Nuk është zbatuar ky rekomandim. Shkaku mos planifikimi i duhur i shpenzimeve dhe mos marrja parasysh e të faktorëve të jashtëm siç janë kushtet atmosferike.
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të inicioj një analizë të plotë pse janë aplikuar praktika të dobëta të prokurimit në këto raste dhe të zbatojë kontrolle të shtuara të cilat sigurojnë se: prokurimet i reflektojnë nevojat; specifikacionet e tenderit i reflektojnë kërkesat aktuale të drejtorive. Në përgjithësi, kontrollet e prokurimit duhet të forcohen.		Pjesërisht është zbatuar ky rekomandim ngase në disa raste ishin lidhur prokurime me vlerë minimale.	

3.4.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari duhet të rishikoj rregulloren e brendshme të aplikuar deri më tani nga komuna, dhe të korrigjoj të njëjtën në pajtim me rregulloren organike dhe ta aplikoj në mënyrë adekuate në mënyrë që të mos dëmtohet buxheti i komunës.			Nuk është zbatuar ky rekomandim. Nuk janë marrë veprime konkrete.
3.5.3 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të siguroj raportim të plotë të obligimeve dhe të forcoj kontrollet dhe disiplinën e zyrtarëve përgjegjës për të përcjellë faturat e pa paguara tek departamenti i financave. Për trajtimin e detyrimeve kontingjente në koordinim me Përfaqësuesin Ligjor të Komunës, duhet të ndërmerri një rishikim të gjendjes së detyrimeve, për të përcaktuar prioritetin e pagesave, duke iu shmangur ekzekutimeve direkte nga MF.			Nuk është zbatuar ky rekomandim. Mungese e raportimit me kohë për faturat e papaguara.
Gjithsej	9	2	3	4

## Shtojca IV: Komentet e Komunës në gjetjet e auditimit

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e komunës në rast të mospajtitimit	Pikëpamja e ZKA-së
<b>Theksimi i çështjes</b>	Jo	<p>Keni potencuar që komuna ka bërë keqklasifikim të shpenzimeve në vlerë prej 40,624 €.</p> <p>Ne mendojmë që komuna ka bërë keqklasifikim të shpenzimeve vetëm në shumë prej 33,749 €, e jo siç e keni potencuar ju në shumën e lartepërmendur.</p> <p>Shuma prej 2,850€ ishte paguar në emër të shpenzimeve për rehabilitimin e 15 personave në banjën e Kllokotit dhe keni potencuar se këto shpenzime i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve.</p> <p>Ne kemi bërë kontratë me operatorin dhe kjo është shërbim për neve dhe mendojmë që nuk hynë në atë grupin e keqklasifikimit.</p> <p>Keni potencuar se shpenzimet në shumë 4,025€ në emër të makinave mjelëse ishin regjistruar si subvencione të cilat do duhej të regjistroheshin si transfere kapitale.</p> <p>Ne mendojmë që shpenzimet në shumë prej 4,025€ në emër të makinave mjelëse janë shpenzuar në kodin adekuat, sepse nuk ka kod të transfereve kapitale dhe këtu kanë përfituar personat individual, pastaj edhe nuk mundën me u regjistruar si pasuri.</p>	Komentet tuaja janë shqyrtuar dhe asgjë në gjetjet e raportit nuk do të ndryshoj. Komentet kanë më tepër qëllime arsyetimi sesa ofrojnë dëshmi të vlefshme për ta ndryshuar raportin.
Çështja 8: <b>Moszbatimi i softuerit për taksa në firmë</b>	Jo	Te softveri për taksën në firmë, ka një defekt programi dhe kemi biseduar me të kompanisë që me ardhje dhe me rregulluar programin .	Në kohën e auditimit, softueri nuk ka punuar.
Çështja 9: <b>Falja e borxheve pa bazë ligjore</b>	Jo	Ne jemi bazuar në Ligjin për Faljen e Borxheve 05/L-043, perkatesisht nenin 4 të këtij ligji, ku thotë se me këtë ligj përfitojnë të gjithë personat që kanë obligime të pashlyera ndaj institucioneve shtetërore dhe ndermarrjeve publike.	Komuna ka falë borxhe të qirasë të cilat nuk janë të lejuara me ligj.

<p><b>Çështja 12:</b> <b>- Lidhja e kontratave me vlerë minimale</b></p>	<p>Jo</p>	<p>2.Mirëmbajtja e ndriçimit publik nuk ishte perfshire fare ne planin e prokurimit edhe pse ky sherbim eshte i rregullt cdo vit, ndersa ishin zhvilluar 2 procedura me kuotim cmimi per kete lloj blerje;</p> <p>2.Te Ndriçimi publik, ju i keni pranuar marreveshjet e nenshkruara me bashkefinancim nga Investimet kapitale pika 4. Mjetet te lira per bashkeinvestime (ku kemi marreveshje mirekuptimi bashkarisht me dy fshatra per bashkefinancimin e projektit ne fjale). Ju i keni pranuar deshmit, pra i keni kopjuar dhe i keni marr me vete) edhe ne listen e buxhetit e keni Ndriçimin publik.</p> <p>Ne ne takimin qe patem me ju, u kemi dorëzuar deshmitë.</p> <p><i>3.Per mirembajtjen dhe servisimin e automjeteve ishin planifikuar mjete 9,000 Euro, ndersa ishin zhvilluar tri procedura te ndara te prokurimit si rezultat i mos-perfshirjes se te gjitha automjeteve ne dispozicion qe ka komuna;</i></p> <p>3.Komuna e Hanit te Elezit, ka zhvilluar procedure te mesme per sherbime per mirembajtjen dhe servisimin e te gjitha automjeteve te Hanit te Elezit dhe nuk kemi pasur asnje ofertues (Data e shpalljes se vleres se mesme 28.10.2016 dhe hapja e ofertes 16.11.2016) dhe ne e kemi anuluar proceduren e prokurimit (dt.anulimit 21.11.2016) dhe per shkak se kane mbetur shume automjete pa servisuar, ne jemi detyruar qe te bejme ndarjen ne dy procedura 1. Mirembajtja e automjeteve per ad.komunale e shpallur ne KRPP me dt.16.12.2016 dhe e hapur me dt.26.12.2016 (Pra procedura e hapur apo publike); <i>Shpallja eshte publike ne KRPP dhe nuk ka pasur asnje lloj dyshimi per favorizime nese ju po aludoni, por sa per njeftim nga shkurti 2016 te gjitha procedurat mbi 1,000 Euro jane publike dhe shpallen ne KRPP dhe jane te hapura per te gjithë operatorët e interesuar.</i></p> <p><i>4.Furnizim me material zyrtar ishte planifikuar ne vlere 4,500 Euro, ndersa ishin zhvilluar 4 (kater) procedura te ndara. Nje rast ishte zhvilluar me procedure te hapur dhe ne tri raste tjera ishte zhvilluar procedura minimale me operatorin e njejte?</i></p>	<p>Nuk ka asnjë dëshmi relevante për të ndryshuar gjetjet e raportit.</p> <p>Raporti mbetet i pandryshuar.</p>
--	-----------	--	--



		<p>4.Furnizim me material zyrtar e keni kontraten per proceduren ne fjale me operatorin NTSH. "STARGRAF" nga Ferizaj, dhe nuk kemi asnje kontrate te njejte per Furnizim me material zyrtar me operatorin e njejte. Ju cfare mendoni eshte kontrate krejtesisht e re, ku jane shperndare ofertat ne shume shtypshkronja dhe ka dal me i lire operatori NTSH. "STARGRAF", por jo ne proceduren e njejte siç po aludoni ju, por procedura (Furnizim me material shtypi). Material zyrtar dhe Material shtypi jane dy procedura qe dallojne njera me tjetren!</p> <p>LIGJI thote që çdo procedure e prokurimit është e ndarë dhe nuk mund tiu ndalohet asnje operatori qe te oferton vetem njehere dhe te mos oferton dy e me shume herë!</p> <p>-Pra, ju e keni listen e artikujve dhe krahasoni cfare artikuj ka operatori kontrate dhe cfare artikuj jane te futur ne material shtypi.</p> <p>Neni 7 par.1 &amp; 2 i LPP 05/L-092; 05/L-068; 04/L-042</p>	
Çështja 13: <b>Inventarizimi dhe përdorimi i E-pasurisë</b>	Jo	Qeshtja e inventarizimit ka filluar me kohe por ende nuk ka perfunduar ne tersi (ka mbetur ne sektorin e arsimit, ne disa shkolla)	Inventarizimi nuk është kryer. Asgjë më shumë nuk thuhet në raport.
Çështja 15: <b>Nivel i lartë i borxheve të pambledhura</b>	Jo	Komuna ka zhvilluar procedura gjyqesore për mos pagesen ndaj operatoreve ekonomik, por palet jane ankuar ne shkallen e dyte, ku po ju percjellim edhe disa nga deshmitë qe i posedojme.	Fakti se komuna ka ushtruar padi, nuk e ndryshon gjendjen.